



**REPUBLIKA E KOSOVËS /**  
**REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO**

---

**C.nr.394/07**

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN**, gjyqtari Lumni Sallauka, me procesmbajtësen Raxhije Emini në kontestin e paditësve A., E., Z., M., B. dhe T. B., të gjithë nga Prizreni, të cilët me autorizim i përfaqëson T. B. nga Prizreni dhe N., I., I.1, N.1 dhe H. B., të gjithë nga Prizreni, të cilët me autorizim i përfaqëson av. M. Ç. nga Prizreni, kundër të paditues Komuna e Prizrenit, të cilën e përfaqëson Avokati Publik Komunal Besim Morina nga Prizreni, me objekt të padisë vërtetimin e nulitetit të kontratës mbi dhuratën dhe dorëzimin në posedim të paluajtshmërisë, vlera e kontestit 100 €, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor, me datën **10.07.2013**, mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

**I. REFUZOHET** kërkesëpadia e paditësve N. B., I. B., I. B.1, N. B.1 dhe H. B., të gjithë nga Prizreni, përmes të cilës kanë kërkuar që “të vërtetohet se në drejtim të tyre është nul kontrata mbi dhuratën e patundshmërisë e lidhur ndërmjet N. B.2 si dhuratëdhënës dhe Komunës së Prizrenit si dhuratëmarrës, e legalizuar në Gjykatën Komunale në Prizren Leg.nr.1534/60, datë 12.12.1960, të detyrohet e paditura Komuna e Prizrenit që paditësve N., I., N.1 , I. B. , të ja dorëzojë në posedim dhe shfrytëzim të lirë 1/3 e patundshmërive me nr. të ngastrës ... , në sipërfaqe prej 55, 79 ari dhe ngastrës kadastrale nr. .... në sipërfaqe prej 4,01 ari, apo gjithësejtë në sipërfaqe prej 59,80 ari, sipas listës poseduese nr..... ZK Prizren, ndërsa paditësit H. B. të ja dorëzoj 1/3 e paluajtshmërive të cekura më lartë, si dhe ti lejoj paditësit që pranë shërbimit për kadastër dhe gjeodezi në Komunën e Prizrenit të regjistrohen si bashkëpronar në lëndët e patundshmërive, të paguaj e paditura shpenzimet procedurale, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga plotëfuqishmëria e këtij aktgjykimi nën kërcënim të përmbarimit me dhunë”, **si tërësisht e pa bazuar.**

**II.** Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

**III.** Padia e paditësve A. B., E. B., Z. B., M. B., B. B. dhe T. B., të gjithë nga Prizreni, konsiderohet **e tërhequr.**

**A r s y e t i m**

Paditësit A. B., E. B., Z. B., M. B., B. B. dhe T. B., të gjithë nga Prizreni, me datë 31.05.2007, kanë parashtruar padi në gjykatë, me të cilën kanë kërkuar që të vërtetohet se është nul kontrata mbi dhurimin e paluajtshmërisë e lidhur ndërmjet N. B.2 si dhuratëdhënës dhe Komunës së Prizrenit si dhuratëmarrës, e legalizuar në Gjykatën Komunale në Prizren Leg.nr.1534/60, datë 12.12.1960, të detyrohet e paditura Komuna e Prizrenit që paditësve si

trashëgimtar ligjor pas vdekjes së paraardhësve juridik, të ja dorëzojë në posedim dhe shfrytëzim të lirë patundshmëritë me nr. të ngastrës .... , në sipërfaqe prej 55, 79 ari dhe ngastrën kadastrale nr. .... në sipërfaqe prej 4,01 ari, apo gjithësejtë në sipërfaqe prej 59,80 ari, sipas listës poseduese nr..... ZK Prizren. Më pas me parashtresën e datës 01.06.2009, paditësit N. B., I. B., I. B., N. B.1 dhe H. B., të gjithë nga Prizreni, kanë kërkuar çasje në padinë e paditësve të lartcekur si paditës së ri (neni 264 parag.2 LPK-së) dhe atë për shkak se të njëjtit janë trashëgimtar ligjor të të ndjerëve K. B. dhe M.B.1 , të cilët sipas tyre kanë legjitimacion aktiv për të gjenë palë në këtë procedurë, por nuk janë përfshirë nga paditësit tjerë.

### *I. Pretendimet e palëve ndërgjyqëse*

Paditësit N. B. etj, të cilët i përfaqëson av. M. Ç., në shqyrtimin kryesor kanë deklaruar se mbesin në tërësi pranë parashtresë së datës 01.06.2009, me të cilën kanë hyrë si paditës të ri në këtë lëndë, duke shtuar se Lëndët e patundshmërisë me nr. të ngastrës .... , në sipërfaqe prej 55, 79 ari dhe ngastrën kadastrale nr. .... në sipërfaqe prej 4,01 ari, apo gjithësejtë në sipërfaqe prej 59,80 ari, sipas listës poseduese nr. .... ZK Prizren, kanë qenë pronësi e përbashkët e vëllezërve N. B.2 , K. B., M. B.1 dhe motrës R. B. , të cilat në bazë të kontratës mbi dhuratën të lidhur ndërmjet Komunës së Prizrenit dhe paraardhësit të paditësve tjerë A. B. etj, M. B.2 , ndërsa paditësit e ri N., I., I. dhe N. B.1 janë trashëgimtarët ligjor të bashkëpronarit M. B.1 , ndërsa H. B. është trashëgimtari i të ndjerit K. B. . Në fjalën përfundimtare deklaroi se nga të gjitha provat e administruara është provuar se paditësit kanë të drejtën legjitime në pjesët e tyre të paluajtshmërive që janë objekt i kontestit. Kështu që për paditësit ka qenë rrethanë e panjohur se pse edhe pjesa e paluajtshmërisë së tyre është evidentuar në emër të të ndjerit N.B.2, përderisa me deklaratën e të ndjerit K. B. të vërtetuar në gjykatë Vr.II.nr.79/2004, dt.29.12.2004, i cili ka sqaruar se me vullnet të plotë dhe me vetëdije të shëndoshë pjesën e tij prej 1/3 të ngastrave kontestuese ia lë djali të tij H.B. . Nda deklarata e tillë buron pa asnjë dilemë se ai me vetëdije të plotë është bindur se ajo paluajtshmëri i takon atij dhe 1/3 i takon vëllaut M.1 , ndërsa vëllau N.2 për pjesën e tij ka marr beneficione përkatëse kur ia ka falur këtu të paditurës pjesën e tij. Nga kjo rrjedh se paraardhësit e këtu paditësve K.dhe M. B.1 kanë qenë të vetëdijshëm se vëllau i tyre N.2 vetëm pjesën e tij (jo të tyre) ia ka falur pushtetit të atëhershëm, pasi ai ka punuar në Komunën e atëhershme dhe i ka gëzuar benefitet e atëhershme, ndërsa vëllezërit e tij kanë punuar si bahqexhi në po këto paluajtshmëri, të cilat tani i kërkojnë pasardhësit e tyre. Me çka sipas saj e drejta në pronë nuk vjetërsohet, ndërsa shkaqet për të cilat tani kërkohet anulimi i kontratës mbi faljen janë të karakterit absolut. Gjithashtu paditësve (neni 14 i Ligjit mbi Marrëdhëniet pronësore juridike) ia njeh të drejtën e pronësisë, pasi ata vazhdimisht i shfrytëzojnë ngastrat kontestuese dhe për këtë e paditura fare nuk ka kundërshtuar. Më tutje ka shtuar se sa i përket pjesës prej 1/3 e paluajtshmërisë që është objekt i këtij kontesti, e cila në bazë të trashëgimisë do ti takonte axhës së paditësve N. B.2 (pasardhësve të tij), vet mos pjesëmarrja e tyre në seancë, jep të kuptosh se ata e pranojnë faktin se paraardhësi i tyre i ka gëzuar benefitet nga e paditura për pjesën e tij 1/3, e që do të nënkuptonte se për pjesën prej 2/3 që do ti takonte paraardhësve të këtu paditësve i njëjti nuk ka mundur të nënshkruaj atë kontratë. Përfundimisht, në fjalën e saj të fundit e autorizuar e paditësve,

gjykatës i ka propozuar që kërkesëpadinë e paditësve ta aprovohet në tërsi si e bazuar. Ndërsa i ka kërkuar edhe shpenzimet procedurale dhe atë 80 euro për çdo seancë të mbajtur.

E paditura Komuna e Prizrenit, përmes përgjigjës me shkrim në padi ka theksuar se e konteston në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë e paditësve, pasi e njëjta është e pabazë dhe në tërësi duhet të refuzohet. Kjo nga shkakun se anulimi i kontratës së kërkuar me padi nuk ka bazë ligjore, pasi e njëjta është lidhur me vullnetin e lirë të palëve. Në shqyrtimin kryesor dhe në fjalën përfundimtare deklaroi se padia dhe kërkesëpadia e paditësve është në tërsi e pa bazuar dhe nuk përmban fakte dhe prova bindëse për theksimet e cekura në padi, sepse vetëm shikimi në shkresat e lëndës së përfunduar dhe deklaratat e dëshmitarëve, nuk mund të shërbejnë si provë në rastin konkret. Kjo ngase edhe nëse ka pasur ndonjë llojë kërcënimi ndaj paraardhëses së paditësve, ky kërcënim eventualisht mund të paraqet vetëm shkelje relative, me ç'rast për këtë bazë kanë kaluar afatet për anulimin e kësaj kontrate, ndërsa që në këtë rast kursesi nuk kemi të bëjmë me nulitetin absolut të kontratës siç pretendojnë paditësit.

## *II. Provat e administruara në shqyrtimin kryesor*

Për vërtetimin e drejtë të gjendjes faktike, gjykata ka administruar provat si në vijim: kontratën mbi dhurimin e patundshmërisë të vërtetuar në Gjykatën Komonale në Prizren Leg.nr.1534/60, dt.27.12.1960, fletëposedimin nr. .... dt. 23.05.2007, çertifikatën e datës 24.05.2007, të lëshuar nga Zyra Komonale e Kadastrit në Prizren, aktvdekjen për të ndjerin K. B. nr. ...-... , dt.25.06.2012, aktvdekjen për të ndjerin M. B.1 nr. ...-... dt.26.06.2012, çertifikatën e lindjes për paditësin N. B.1 nr. ... , dt.30.06.2009, çertifikatën e lindjes për paditësin I. B.1 nr. ... , dt.09.06.2009, çertifikatën e lindjes për paditësin I. B. nr. ... , dt.30.06.2009, çertifikatën e lindjes për paditësin N. B. nr. .. , dt.30.06.2009, çertifikatën e lindjes për paditësin H. B. nr. .../.... , dt.13.09.2002, çertifikatën e vdekjes për të ndjerën M. B.2 nr. ... dt. 15.04.2009, kontratën mbi ndarjen e bashkësisë familjare Leg.nr.2390/60, dt. 17.11.1960, deklaratën e të ndjerit K. B. Vr.II.nr.79/2004, dt.29.12.2004, ekspertizën e ekspertit të gjeodezisë L. R. të dt. 22.02.2013, ka dëgjuar dëshmitarët Z. B.2 dhe A. K. .

Gjykata pas vlerësimit të pohimeve të palëve ndërgjyqëse dhe provave të lartëcekura, në kuptimin e nenit 8 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), me kujdes dhe me ndërgjegje ka çmuar çdo provë veç e veç dhe të gjitha ato së bashku dhe ka gjetur se lërkesëpadia e paditësve duhet të refuzohet si e **pa bazuar**.

## *III. Faktet*

Me leximin e kopjes së kontratës mbi dhuratën e patundshmërisë Leg.nr.1534/60, datë 12.12.1960, gjykata ka vërtetuar faktin se N.B.2 si dhuratëdhënës, i'a kishte dhuruar Komunës së Prizrenit, si dhuratëmarrëse ngastrën nr. .... , në sipërfaqe prej 55, 79 ari dhe ngastrën kadastrale nr. ....

në sipërfaqe prej 4,01 ari, apo gjithësejtë sipërfaqen prej 59,80 ari, sipas listës poseduese nr. .... ZK Prizren.

Me leximin e ekstraktit nga fletëposedimi nr. .... , datë 23.05.2007, të lëshuar nga Drejtoria për Gjeodezi dhe Kadastër të Komunës së Prizrenit, gjykata ka vërtetuar faktin se ngastrat nr. .... dhe nr. .... , në sipërfaqe prej 59.80 ari, evidentohen në emër të P.SH Komuna e Prizrenit.

Me leximin e çertifikatës nr. ... Nr. ../Gj, datë 24.05.2007, të lëshuar nga Zyra Komunale e Kadastrit të Komunës së Prizrenit, gjykata ka konstatuar ndër të tjera se ngastrat nr. .... dhe nr. .... , prej matjes detale të vitit 1953, e cila ka hyrë në fuqi në vitin 1957, janë evidentuar në pronësi të N. I.B.2 nga Prizreni, deri në vitin 1960. Në vitin 1960 ngastrat kadastrale të përmendura më lartë pësojnë ndërrime në bazë të Kontratës mbi dhurimin Leg.nr.1534/60, dt. 27.12.1960, të vërtetuar në Gjykatën Komunale në Prizren dhe kalojnë në pronësi të P.SH.KK Prizren, fleta poseduese e vjetër nr. .... ZK Prizren (regjistri i ndërrimeve nr. .../.. ). Sipas shënimeve kompjuterike të vitit 1995 dhe deri në lëshimin e kësaj çertifikate ngastrat në fjalë evidentohen në emër të P.SH.KK Prizren, sipas fletës poseduese nr. .... ZK Prizren.

Me leximin e aktvdekjes nr.200-259 dt.26.06.2012, gjykata e ka vërtetuar faktin e vdekjes së të ndjerit Mehmedali Bytyqi, përkatësisht paraardhësit të këtu paditësve (përveç Hajret Bytyqit).

Me leximin e aktvdekjes nr. ...-... , dt.25.06.2012, gjykata ka vërtetuar faktin e vdekjes së të ndjerit K. B. , përndryshe paraardhsin e paditësit H.B. .

Me leximin e çertifikatave të lindjes për paditësit N. B.1 nr. ..., dt.30.06.2009, I. B. nr. ... , dt.09.06.2009, I. B. nr. ... , dt.30.06.2009 dhe N. B. nr. .. , dt.30.06.2009, gjykata ka vërtetuar faktin se të njëjtit janë trashëgimtarët ligjot të të ndjerit M. B.1 . Ndërsa me leximin e çertifikatës së lindjes për paditësin H. B. nr. .../.... , dt.13.09.2002, gjykata vërtetoi faktin se i njëjti është trashëgimtar ligjor i të ndjerit K. B. , i cili me deklaratën Vr.II.nr.79/2004, dt.29.12.2004, të vërtetuar në Gjykatën Komunale në Prizren të drejtën për të trashëguar pjesën e ngastrave kontestuese prej 1/3 ia bartë këtu paditësit H. B. .

Me leximin e ekspertizës së ekspertit të gjeodezisë të angazhuar në këtë çështje kontestimore, L. R. , të datës 22.02.2013, gjykata ka konstatuar se ngastrat nr. .... dhe nr. .... në vendin e quajtur “.....”, me kulturë jopjellore, në sipërfaqe prej 59.80 ari, prej matjes detale të vitit 1953, e cila ka hyrë në fuqi në vitin 1957, janë evidentuar në pronësi të N. I. B.2 nga Prizreni, deri në vitin 1960. Në vitin 1960 ngastrat kadastrale të përmendura më lartë pësojnë ndërrime në bazë të Kontratës mbi dhurimin Leg.nr.1534/60, dt. 27.12.1960, të vërtetuar në Gjykatën Komunale në Prizren dhe kalojnë në pronësi të P.SH.KK Prizren, fleta poseduese e vjetër nr. .... ZK Prizren (regjistri i ndërrimeve nr. .../.. ). Në vendin e ngjarjes është bërë identifikimi i ngastrave lëndore dhe është konstatuar se ngastra kadastrale .... është e lirë, në të njëjtën nuk ka objekte të ndërtuara, si dhe bimë shumëvjeçare dhe aktualisht shfrytëzohet si livadhë, ndërsa nëpër ngastrën kadastrale .... është bërë zgjerimi i rrugës së asfaltuar Prizren-Novosellë dhe një pjesë e sipërfaqes ka hyrë në kuadër të rrugës, ndërsa pjesa tjetër e ngastrës një pjesë e saj në veri është

livadhë, ndërsa në jug është e pyllëzuar me drunjë të ndryshëm. Në vitin 2008 në bazë të vendimit për miratimin e planit rregullues urban për lokacionin “Dardania-2” të Prizrenit (kontesti i gjerë hapësinor) Nr. ../.-.... , dt.17 korrik 2008-Komuna e Prizrenit-Kuvendi i Komunës, ngastrat lëndore janë përfshirë në Planin Rregullues Urban, ndërsa me këtë ngastrat kanë ndryshuar formën, sipërfaqen dhe kulturën, për shkak të rregullimit të infrastrukturës-rrugëve e sipërfaqet janë zvogëluar prej 20-24 %. Ekspertizës me shkrim, ekspertja në fjalë i’a ka bashkangjitur edhe skicën përkatëse, ku me ngjyrë të kuqe është shënuar gjendja pas hyrjes në fuqi të planit urbanistik.

Me leximin e kontratës mbi ndarjen e bashkësisë familjare Leg.nr.2390/60, dt. 17.11.1960, e lidhur ndërmjet tani të ndjerëve N. B.2 , M. B.1 dhe K. B. (përndryshe vëllezër), gjykata vërtetoi faktin se ngastrat kontestuese nuk kanë qenë pjesë e pasurisë së përbashkët të tyre, më saktësisht nuk janë përfshirë në këtë kontratë.

#### *IV. Baza ligjore*

Në nenin 111 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD), në mënyrë decisive është paraparë se **“kontrata është e rrzueshme kur e ka lidhur pala me zotësi të kufizuar për të vepruar, kur gjatë lidhjes së saj ka pasur të meta në pikëpamje të vullnetit të palëve, si dhe kur kjo gjë është e caktuar me këtë ligj ose dispozitë të veçantë”**. Ndërsa me nenin 117 të po këtij ligji parashihet se **“e drejta për të kërkuar anulimin e rrzueshmërisë së kontratës pushon me skadimin e afatit prej një viti nga data kur të jetë ditur shkaku i rrzueshmërisë, respektivisht pushimit të dhunës. Kjo e drejtë në çdo rast pushon me skadimin e afatit prej 3 vitesh nga data e lidhjes së kontratës”**.

#### *V. Vlerësimet faktike dhe juridike të gjykatës*

Duke marr parasysh të gjitha pretendimet e palëve ndërgjygjëse dhe provat e administruara në lidhje me këtë çështje kontestimore, gjykata ka ardhur në përfundim se kërkesëpadia e paditësve është e pa bazuar dhe se duke u bazuar në dispozitat ligjore të lartëcituara, e njëjta duhet të refuzohet në tërësi si e pabazuar.

Gjykatës i rezultoi se paditësit (të cilët janë përfshirë në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi) me asnjë provë të vetme nuk vërtetuan faktin se paraardhësit e tyre M. B.1 dhe K. B. kanë qenë bashkëpronar të ngastrave kontestuese. Nëse i referohemi kontratës mbi ndarjen e bashkësisë familjare Leg.nr.2390/60, dt. 17.11.1960, e lidhur ndërmjet tani të ndjerëve N. B.2, M. B.1 dhe K. B. (përndryshe vëllezër), rezulton se ngastrat kontestuese nuk kanë qenë pjesë e pasurisë së përbashkët të tyre, më saktësisht nuk janë përfshirë fare në këtë kontratë, ndërsa kjo kontratë është lidhur më herët se kontrata mbi dhurimin e paluajtshmërisë Leg.nr.1534/60, e cila mban datën 27.12.1960. Kështu që pretendimi i të autorizuares së paditësve av. M. Ç. se paraardhësit e këtu paditësve të cilët i përfaqëson kanë qenë bashkëpronar me 1/3 e patundshmërive kontestuese nuk qëndron. Kjo për faktin se në bazë të

provave të administruara, përfshirë këtu ekspertizën e ekspertës së gjeodezisë dhe çertifikatën nr. ... Nr. ../Gj, datë 24.05.2007, të lëshuar nga Zyra Komonale e Kadastrit të Komunës së Prizrenit, është vërtetuar se ngastrat nr. .... dhe nr. .... , prej matjes detale të vitit 1953, e cila ka hyrë në fuqi në vitin 1957, janë evidentuar në pronësi të N. I. B.2 nga Prizreni, deri në vitin 1960, i cili është paraardhësi i paditësve për të cilët është vendosur në pikën III të dispozitivit të këtij aktgjykimi, kurse nga viti 1960 ngastrat kadastrale të përmendura më lartë pësojnë ndërrime në bazë të Kontratës mbi dhurimin Leg.nr.1534/60, dt. 27.12.1960, të vërtetuar në Gjykatën Komonale në Prizren dhe kalojnë në pronësi të P.SH.KK Prizren, fleta poseduese e vjetër nr. .... ZK Prizren (regjistri i ndërrimeve nr. .../.. ).

Përkundër të lartcekurave, me dispozitat e Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD), është përcaktuar qartë se kur gjatë lidhjes së kontratës përkatëse, ka pasur të meta në pikëpamje të vullnetit të palëve (kërcënim, lajthim, dhunë etj), atëherë kemi të bëjmë me kontrata të rrëzueshme, e jo me kontrata nule. Pra në rastin në fjalë kemi të bëjmë me një kontratë të rrëzueshme. E drejta për të kërkuar anulimin e rrëzueshmërisë së kontratës pushon me skadimin e afatit prej një viti nga data kur të jetë ditur shkak i rrëzueshmërisë, respektivisht pushimit të dhunës. Kjo e drejtë, në çdo rast pushon me skadimin e afatit prej 3 (tre) vitesh nga data e lidhjes së kontratës (neni 117 parag.2 i LMD). Afati në fjalë është afat prekluziv. Në bazë të provave të administruara në këtë çështje kontestimore, del se kontrata mbi dhuratën Leg.nr.1534/60, anulimi i të cilës kërkohet, është lidhur me dt. 27.12.1960, ndërsa padia e paditësve për anulimin e kësaj kontrate është bërë me 31.05.2007, fillimisht nga paditësit A. B. etj, ndërsa paditësit e tjerë janë kyqur në këtë lëndë me datë 01.06.2009, që i bie dikund pas 47, përkatësisht 49 vitesh. Bazuar në të lartcekurat, gjykata vlerëson se nuk mund të kërkohet anulimi i kontratës përkatëse të rrëzueshme, siç është rasti në fjalë, pas afatit ligjor prekluziv 3 vjeçar, andaj edhe vendosi që kërkespadinë e paditësve ta refuzoj në tërësi sikurse në dispozitivin **I** të këtij aktgjykimi.

Gjykata vlerëson se janë të pabazuara pretendimet të autorizuarës së paditësve se në rastin konkret është në pyetje nuliteti i kontratës nga neni 103 i Ligjit mbi marrëdhëniet detyimore, në bazë të të cilit nulitet në kuptim të nenit 110 të LMD-së, e drejta për të kërkuar anulimin e kontratës nuk shuhet.

Gjykata gjithashtu ka vlerësuar edhe provat dhe theksimet e tjera të palëve ndërgjyqëse (përfshirë këtu deklaratimet e dëshmitarëve Z. B.2 dhe A. K.), por ka gjetur se të njëjtat janë pa ndikim në nxjerrjen e këtij aktgjykimi.

Gjykata vendosi si në pikën **III** të dispozitivit të këtij aktgjykimi konform nenit 423.3 të LPK-së, pasi që i autorizuari i paditësve A. B., E. B., Z. B., M. B. dhe B. B., T. B. (i cili edhe vet është paditës) nuk ka prezentuar në shqyrtimin kryesor të mbajtur me datë 18.06.2013, përkundër faktit se i njëjti ka qenë i ftuar në mënyrë të rregullt, por mungesën nuk e ka arsyetuar. Ky fakt vërtetohet me shikimin e fletëdërgesës për dorëzim personal dhe procesverbalit të shqyrtimit kryesor të datës 18.06.2013 (ku gjykata me aktvendim të marr në procesverbal ka vendosur që padinë e paditësve ta konsideroj të tërhequr). Mbi këtë bazë gjykata nuk u lëshua në administrimin dhe vlerësimin e provave materiale të propozuara nga i autorizuari i këtyre paditësve.

Gjykata nuk e shqyrtoi fare parashtresën e dorëzuar në gjykatë me datë 22.07.2013 nga av. Y. K. nga Prizreni, pasi që e njëjta është dorëzuar pas përfundimit të shqyrtimit kryesor i cili është mbajtur me datë 10.07.2013 (në fazën e hartimit të këtij aktgjykimi) dhe për shkak se ishte jo relevante pasi që T. B. i ka përfaqësuar të gjithë paditësit për të cilët është vendosur si në pikën III të dispozitivit të këtij aktgjykimi (në shkresat e lëndës janë të gjitha autorizimet përkatëse të cilat janë vërtetuar në Gjykatë).

Vendimi mbi shpenzimet procedurale është marrë konform nenit 452.4 të LPK-së, për faktin se përfaqësuesi i të paditurës në shqyrtimin kryesor deklaroi se nuk i kërkon shpenzimet procedurale.

Nga sa u tha më lart, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, e duke u bazuar në nenin 117 të LMD-së, lidhur me nenin 143.1 të LPK-së.

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN**  
**C.nr.394/07, datë 10.07.2013**

**Procesmbajtësja**  
**Raxhije Emini**

**Gjyqtari**  
**Lumni Sallauka**

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi pala e pa kënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 ditësh, pas ditës së pranimi të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj gjykate.